



Pranuar / Dorezuar Prijmjen / Prodato Received / Delivery	21. 01	2021	1	viti god year
Organ / Njësia Org./Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKRIMSHACK	239/2021		116	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.404/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani -anëtar, sidhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.404/2020 të datës 08.12.2020 të parashtruar nga ankuesit:

me autorizim i përfaqëson Avokat me adresë "Dr. Bajram Krasniqi", Nr. 7 në Podujevë, kundër organit të punësimit Komuna e Malishevës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 20.01.2021, mori këtë:

### V E N D I M

I. HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.404/2020 e datës 08.12.2020 e parashtruar nga ankuesit.

dhe

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, Shpallet jo kompetent për te vendosur për ankesën me numër A.nr.404/2020 të datës 08.12.2020 të parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

Komuna e Malishevës në bazë të vendimeve të datës 25.11.2019, 27.11.2019, 29.11.2019, 10.12.2020, 03.12.2019, 07.12.2020, të gjithë ankuesve i'u ka bërë kompensimin e shpërblimit jubilar në vlerën e 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil. Po ashtu Komuna e Malishevës, me datën 02.12.2020 ka nxjerr vendimin me numër Nr.02/464, me të cilin ka lejuar pagesën për shujta për të gjithë të punësuarit e administratës (shërbyesve civil si dhe shërbimit të zjarrfikësve) .Ankuesit me datën 02.07.2020 kanë parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Malishevës me pretendimin për kompensimin e pagës së trembëdhjetë (13), pagesën e shpërblimit jubilar sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pagesën përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi të tri pagave dhe pagesën e ushqimit ditore për ditët e praninë në punë. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Malishevës më datë 16.09.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 01/918 me të cilin është shpall jo kompetent për shqyrtimin e ankesës.

Ankuesit, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, me postë kanë parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila më datë 08.12.2020 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe është protokolluar me numër 3012/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 15.12.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve në Komunën e Malishevës. Me datë 05.01.2021 , Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Malishevës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 3012/2020 të datës 08.12.2020 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 18.02.2020; Listën me nënshkrim të punëtorëve të administratës së Komunës së Malishevës; Akt Emërimit e datës 06.06.2015 për ankuesin me ID identifikuesve të tij; Akt Emërimit e datës 04.01.2012 për ankuesin me ID identifikuesve të tij; Akt Emërimit e datës 25.01.2012 për ankuesin me ID identifikuesve të tij; Akt Emërimit e datës 24.01.2012 për ankuesin me ID identifikuesve të tij; Akt Emërimit e datës 24.01.2012 për ankuesin me ID identifikuesve të saj; Akt Emërimit e datës 05.02.2013 për ankuesin me ID identifikuesve të saj; Akt Emërimit e datës 24.01.2012 për ankuesin me ID identifikuesve të saj; Akt Emërimit e datës 10.03.2017 për ankuesin me ID identifikuesve të saj; Akt Emërimit e datës 02.02.2012 për ankuesin me ID identifikuesve të saj; Akt Emërimit e datës 01.04.2015 për ankuesin me ID identifikuesve të saj; Akt Emërimit e datës 01.02.2012 për ankuesin me ID identifikuesve të saj; Akt Emërimit e datës 04.01.2012 për ankuesin me ID identifikuesve të saj; Akt Emërimit e datës 02.02.2012 për ankuesin me ID identifikuesve të saj; Akt Emërimit e datës 01.04.2014 për ankuesin me ID identifikuesve të saj; Akt Emërimit e datës 25.01.2012 për ankuesin me ID identifikuesve të saj; Akt Emërimit e datës 04.01.2012 për ankuesin

Akt Emërimin e datës 10.03.2017 për ankuesen

Akt Emërimin e datës 25.01.2012 për ankuesin

Akt Emërimin e datës

01.04.2014 për ankuesin

Akt Emërimin e datës 01.11.2012 për ankuesin

Akt Emërimin e datës 02.04.2013 për ankuesen

Akt Emërimin e

datës 24.01.2012 për ankuesin

; Akt Emërimin e datës 11.01.2012 për

ankuesen

Akt Emërimin e datës 24.01.2012 për ankuesen

Akt

Emërimin e datës 21.05.2019 për ankuesin

; Akt Emërimin e datës 06.06.2015 për

ankuesin

Vendim me numër Nr.02/464 i datës 02.12.2020 nga Kryesuesi i

Kuvendit të Komunës së Malishevës; Vendim me numër Nr.01/918 i datës 16.09.2020, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Malishevës; Ankesa e ankuesve përmes përfaqësuesit ligjor të tyre e datës 30.06.2020 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Listën e pagave për punëtorët për periudhën 01.09.2020, 01.12.2019, 01.12.2020, nga Komuna e Malishevës; Vendimin me Nr. 01/1488 i datës 27.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1487 i datës 25.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1506 i datës 29.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1516 i datës 29.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1518 i datës 29.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1519 i datës 29.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1520 i datës 29.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1549 i datës 03.12.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1547 i datës 03.12.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1550 i datës 03.12.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1468 i datës 27.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1508 i datës 20.11.2019 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1309 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1310 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1309 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1310 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1311 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1312 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1316 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1319 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1257 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1256 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1255 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1254 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1253 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile); Vendimin me Nr. 01/1252 i datës 07.12.2020 për shpërblim të përvjetorit (jubile);

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesit dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesve

. dhe

, është e pa lejuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesve të cilët pretendojnë për kompensimin e pagës së trembëdhjetë (13), pagesën e shpërblimit jubilar sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektiv, pagesën përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi të tri pagave dhe pagesën e ushqimit ditore për ditët e praninë në punë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës, ka gjetur se ankuesit janë të punësuar në Komunën e Malishevës, të cilët me datë 18.02.2020 i janë drejtuar me kërkesë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa si dhe Zyrës së Personelit në Komunën e Malishevës, për njohjen e të drejtave të pretenduara si në ankesë, por siç deklarojnë, asnjëherë nuk kanë pranuar ndonjë përgjigje lidhur me kërkesën e tyre. Ndërsa me datë 02.07.2020, ankuesit përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit kanë parashtruar ankesë, me bazë të njëjtë, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Malishevës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Malishevës më datë 16.09.2020 ka nxjerr Vendim me Nr.01/918 me të cilin është shpall jo kompetent për shqyrtimin e ankesës të ankuesve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 50 paragrafi 1, dhe nenin 81 paragrafi 2 nen paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, i cili ka qenë i aplikueshëm deri me datë 09.07.2020, si dhe nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht deklarimin e ankuesve se me datë 18.02.2020 i janë drejtuar me kërkesë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa si dhe Zyrës së Personelit në Komunën e Malishevës, për njohjen e të drejtave të pretenduara si në ankesë, Ankesën e datës 02.07.2020 të parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pran Komunës së Malishevës, si dhe Vendimin Nr.01/918 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me të cilin është shpall jo kompetent për shqyrtimin e ankesës të ankuesve, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se ushtrimi i ankesës me datë 08.12.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjore të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në piken 1 të këtij vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, Shpallet jo kompetent për vendosur për ankesën me numër A.nr.404/2020 të datës 08.12.2020 të parashtruar nga ankuesit dhe shpallet jo kompetent për të vendosur *sepse*:


Ndërsa ankuesit dhe në bazë të provave të lëndës mbajnë pozita "Roje Pylli", "Mirëmbajtës i shtëpisë se kulturës", dhe "Roje e sigurisë se objektit", në Komunën e Malishevës, në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 2 paragrafit 6 përcaktohet që: *"Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike"*, andaj duke marr parasysh këto pozita "Roje Pylli", "Mirëmbajtës i shtëpisë se kulturës", dhe "Roje e sigurisë se objektit" nuk janë pozita te nëpunësve civil, por janë pozita që kane statusin nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës. Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e themelimit të marrëdhënies së punës së ankuesve, përkatësisht neni 4 paragrafi 4 personelin mbështetës ka përjashtuar nga Shërbimi Civil, duke përcaktuar se: *"Personeli i punësuar nga institucionet e administratës në nivel qendror dhe komunal, përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes, nuk janë nëpunës civilë"*, ndërsa Ministria e Administratës Publikë me datën 08.12.2014, ka nxjerr Qarkore Administrative, e cila ka përcaktuar se pozitat "roje" dhe "mirëmbajtës" hyn në kuadër të pozitave me funksione mbështetëse, dhe ka udhëzuar institucionet që marrëdhënia e tyre të rregullohet me Ligjin e Punës. Në bazë të nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet që: *"Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente"*, mbi këtë bazë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në bazë të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.404/2020

Ardita Perçuku-Shyti

  
Zyrtare e Lartë për bashkëpunim profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesve Avokat z.
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Malishevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

